

## **SHTOJCA 1. RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE**

---

RAPORT I AUDITUESEVE TE PAVARUR -ENTI RREGULLATOR I ENERGISË (ERE)  
[AUDITIM PËR PASQYRAT FINANCIARE TE VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2022]  
[ADRESA: BLV. "BAJRAM CURRI", RRUGA "VIKTOR EFTIMIU" 1023; e-mail: [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)  
TIRANË, SHQIPËRI

---

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR**

Për: Z.Petrit Ahmeti

Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë

Blv. "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" 1023, Tiranë, Shqipëri

**Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022.****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Entit Rregullator të Energjisë-ERE, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2022, pasqyrën e performancës financiare (burimeve dhe përdorimit), pasqyrën e ndryshimeve për fondet e akumuluarra dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më datën 31 Dhjetor 2022, përfshire shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar më datën 31 Dhjetor 2022, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuar) (SKKP), Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike" [neni3 (pika 52 dhe 53); neni 11; neni 17]].

**Baza për opinionin**

Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKKP dhe Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" e Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike" (neni 17) dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entitetit për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Entitetit.

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arësyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arësyeshme megjithëse është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Raporti i audituesve të pavarur është i vlefshme vetëm për pasqyrat financiare 2022 bashkëlidhur.

1

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Entiteti të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e institucionit, përveç se çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor (Partner Angazhimi)  
  
 Ermir Veipi  
 CONSULTING PARTNERS sh.p.k.  
 License: Nr.261; 27.06.2012  
 Adresa: Komuna e Parisit, Pallati Niku  
 Konstruksion, Kati 7, Ap. 61  
 consultingpartnersshpk@gmail.com

Auditues Ligjor  
  
 Kondor Çeka  
  
 License: Nr. 480; 16.09.2021  
 Adresa: Nj.8, nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi,  
 P.18, Hyrja 4, Ap.21, Tirane  
 e-mail: dori.ceka@viar.al

Tiranë më 23/03/2023

Raporti i audituesve të pavarur është i vlefshme vetëm për pasqyrat financiare 2022 bashkënlidhur.  
 2

---

**PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2022  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)**

---

**NIPT:** K517170241  
**Adresa:** Blv. "Bajram Curri",  
Rruga "Viktor Eftimiu" 1023  
e-mail: [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 16/03/2023

Enti Rregullator i Energjisë -ERE  
 Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2022  
 (Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

## Përmbajtja


Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet).....	2
Pasqyra e ndryshimit të Fondeve.....	3
Pasqyra e flukseve monetare.....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5
A. Informacion i përgjithshëm.....	5
B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare.....	5
C. Politikat kontabile.....	6
1. Transaksionet në monedhë të huaj.....	6
2. Instrumentat financiare.....	6
3. Inventaret.....	6
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t).....	8
5. Qiratë.....	8
6. Transaksionet me palët e lidhura.....	9
7. Grantet qeveritare.....	9
8. Të Ardhurat dhe shpenzimet.....	9
9. Përfitimet e punonjësve.....	9
10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara.....	10
11. Korrigjimi i gabimeve.....	10
12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare.....	10
D. Shënime për Pozicionet Financiare.....	10
1. Mjetet monetare.....	10
2. Të arkëtueshme.....	10
3. Inventarët.....	11
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM).....	11
5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit.....	12
6. Të ardhurat nga aktiviteti.....	13
7. Shpenzimet për personelin.....	13
8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi.....	13
9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi.....	13
10. Shpenzime financiare.....	13
11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve.....	14
12. Teprica e Fondeve më 31.12.2022.....	14
13. Palet e lidhura.....	14
14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara.....	14
15. Kontrollat tatimore.....	14
16. Ngjarje pas datës së bilancit.....	14

Enti Rregullator i Energjisë -ERE  
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2022  
(Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

## Pasqyra e pozicionit financiar

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare			
Investime	1	89.624.668	56.240.725
<b>Te drejta te arketueshme</b>			
Nga aktiviteti i shfrytëzimit		-	-
Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese	2	7.391.079	11.426.152
Te tjera		-	-
Kapital i nenshkruar i papaguar		1.856.928	436.857
<b>Inventaret</b>			
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	3	4.941.492	3.107.381
<b>Shpenzime te shtyra</b>			
<b>Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara</b>			
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>103.814.167</b>	<b>71.211.116</b>
<b>Aktive afatgjate</b>			
<b>Aktive financiare</b>			
<b>Aktive materiale</b>			
Toka dhe ndertesa		-	-
Makineri e Pajisje		-	-
Mjete Transporti	4	4.752.931	5.941.168
Pajisje Zyresh	4	6.334.654	7.031.192
Te tjera pajisje dhe Informatike	4	35.254.563	39.069.624
<b>Aktivet biologjike</b>			
<b>Aktive jo materiale</b>			
Koncension, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te naishme	4	52.894.864	63.410.106
Emri i mire		-	-
Parapagime per AAJM		-	-
<b>Aktivitet tatimore te shtyra</b>			
<b>Totali i aktiveve afatgjate</b>		<b>99.237.012</b>	<b>115.452.089</b>
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>203.051.178</b>	<b>186.663.205</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytëzimit	5	779.083	1.169.444
Deftesa te pagueshme		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa		-	-
Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve	5	3.018.559	2.005.067
Te pagueshme per detyrime tatimore	5	2.926.015	2.964.373
Te tjera te pagueshme	5	60.517	67.169
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>			
<b>Te ardhura te shtyra</b>			
<b>Provizione</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>6.784.174</b>	<b>6.206.053</b>
<b>Detyrime afatgjate</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjate</b>			
<b>Detyrime Totale</b>		<b>6.784.174</b>	<b>6.206.053</b>
<b>Fondet te akumuluar - ERE</b>			
Rritje/Rënie fondesh gjate vitit	11	180.457.152	166.470.859
Shuma		15.809.852	13.986.292
<b>Totali i Detyrimeve dhe i Fondeve</b>		<b>203.051.178</b>	<b>186.663.205</b>

Hartuesi i Pasqyrave Financiare  
Aferdita Bushi



Kryetar  
Petrit Ahmeti



Enti Rregullator i Energjisë -ERE  
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2022  
(Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

## Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet)

		Viti 2022	Viti 2021
<b>Te ardhura te shfrytezimit</b>			
Te ardhurat nga Faturimi / Operatoreve	6	209.781.572	207.671.534
Te ardhurat nga Licensimi	6	20.330.710	10.796.150
Te tjera te ardhura nga organizma mbulim shpenzimesh		-	-
<b>Te ardhura te tjera te shfrytezimit</b>		-	-
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme</b>		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme		-	-
Te tjera shpenzime		-	-
<b>Shpenzime te personelit</b>		-	-
Paga dhe shperblime	7	(139.337.160)	(149.503.066)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	7	(16.520.843)	(16.129.562)
Shpenzimet per pensionet		-	-
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(23.041.112)	(14.389.798)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	9	(36.067.601)	(24.411.287)
<b>Te ardhura te tjera</b>		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interese		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te		-	-
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve</b>		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme		(82.668)	(84.594)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu		-	-
Shpenzime te tjera financiare	10	746.954	36.916
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesemarrjet</b>		-	-
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	11	<b>15.809.852</b>	<b>13.986.292</b>
<b>Tatimi mbi fitimin</b>			
Tatimi mbi fitimin e periudhes		-	-
<b>Tatim fitimi i shtyre</b>			
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve		-	-
<b>Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve</b>		<b>15.809.852</b>	<b>13.986.292</b>

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Aferdita Bushi



Kryetar

Petrit Ahmeti





Enti Rregullator i Energjisë -ERE  
 Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbylltur 31. Dhjetor 2022  
 (të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

### Pasqyra e ndryshimit të Fodeve

	Fondet Të Akumuar - ERE	Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar ne fillim 01.01.2021</b>	<b>106.054.620</b>	<b>60.416.239</b>	<b>166.470.859</b>
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile			
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim</b>	<b>106.054.620</b>	<b>60.416.239</b>	<b>166.470.859</b>
<b>Rezultati viti paraardhes</b>	60.416.239	(60.416.239)	-
<b>Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit</b>		13.986.292	13.986.292
<b>Pozicioni financiar ne fund 31.12.2021</b>	<b>166.470.859</b>	<b>13.986.292</b>	<b>180.457.152</b>
<b>Rezultati viti paraardhes</b>	13.986.292	(13.986.292)	-
<b>Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit</b>	-	15.809.852	15.809.852
<b>Pozicioni financiar ne fund 31.12.2022</b>	<b>180.457.152</b>	<b>15.809.852</b>	<b>196.267.004</b>


Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Aferdita Bushi




Kryetar

Petrit Ahmeti



Enti i Rregullatorit të Energjisë - ERE  
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2022  
(Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

## Pasqyra e flukseve monetare

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:</b>		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	15.809.852	13.986.292
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23.041.112	14.389.798
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	2.615.002	15.309.410
Renie/(Rritje) ne inventar	- 1.834.111	- 450.135
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme	578.121	- 18.168.648
Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit		
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>40.209.977</b>	<b>25.066.717</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	- 6.826.035	83.276.191
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit</b>	<b>- 6.826.035</b>	<b>- 83.276.191</b>
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>33.383.942</b>	<b>- 58.209.473</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	56.240.726	114.450.199
Efeki i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare	-	-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund</b>	<b>89.624.668</b>	<b>56.240.726</b>

Hartuesi i Pasqyrave Financiare  
Aferdita Bushi



Kryetar  
Petrit Ahmeti



**Entit Rregullator të Energjisë (ERE)  
Letra e menaxhimit për periudhën  
Janar-Dhjetor 2022**

Të nderuar zotëri,

Grupi ynë i auditimit ka ekzaminuar kontrollin e brendshëm dhe pasqyrat financiare të Entit Rregullator të Energjisë. Sistemet e kontabilitetit dhe ato të kontrollit janë verifikuar deri në masën e nevojshme që lejon përcaktimi i procedurave të auditimit për raportim në pasqyrat financiare.

Gjatë auditimit kemi evidentuar disa problematika për të cilat kemi bashkëngjitur rekomandimet tona, në mënyrë për të ndihmuar në përmirësimin e proceseve dhe për të arritur efikasitet operacionale.

Komentet dhe rekomandimet e bashkëngjitura kanë si qëllim të vetëm informimin dhe përdorimin e drejtuesve të institucionit dhe palëve të interesuara.

Faleminderit juve dhe stafit tuaj për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme gjatë procesit të auditimit.


Auditues Ligjor (Partner Angazhimi)

Ermir Veipi

  
CONSULTING PARTNERS SH.P.K.  
License: Nr.261, 27.08.2012  
Adresa: Komuna e Parisit, Rr. Hafi Niku  
Konstruksion, Kati 7, Ap. 61  
Tiranë - ALBANIA  
consultingpartnersshpk@gmail.com

Auditues Ligjor

Kondor Çeka

  
License: Nr. 480; 16.09.2021  
Adresa: Nj.8, nr.2, Rruga Luigj  
Gurakuqi, P.18, Hyrja 4, Ap.21, Tirane  
e-mail: dori.ceka@viar.al

Tiranë, më 23.03.2023

## Aneksi 1. Letra e menaxhimit

Gjetje	Rekomandime	Komentet e drejtimit
<p><b>Përgatitja e Pasqyrave Financiare</b></p> <p>Pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2022 janë përgatitur në një platformë excel të cilat në gjykim e audituesit ligjor mund të mbarin pasiguri mbi interpretimin kronologjik dhe logjik për të kuptuar skemat kontabile të aktivitetit. Për rrjedhojë, përgatitja në formate excel mbart një pasiguri materiale që mund të supozojmë dyshime për gabime njëzore.</p> <p>Audituesit ligjor konstatojnë se ERE nuk ka një metodologji të miratuar për mënyrën e trajtimit të logorive të arkëtueshme të cilat arkoohen me vonë ose nuk arrijnë të arkoohen. Më dhjetor 2022 shuma e debitorëve të parkëtuar mbi 300 ditë është 5,239 mijë lekë.</p>	<p>Entiteti ka prokuruar software Financa5 për mbajtjen e kontabilitetit. Informacioni kontabël gjendet më 31,12,2022 duhet çelur në këtë software, dhe gjithë transaksionet dhe veprimet kontabël për vitin 2023 të regjistruhen në të, duke rritur sigurinë dhe cilësinë e sistemit kontabël të Entitetit.</p> <p>Në fund të çdo periudhe raportimi, Entiteti në bazë të një metodologjie duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar dhe nëse ekziston një evidencë objektive të zhvlerësimit, Entiteti duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.</p>	<p>Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.</p> <p>Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.</p>
<p><b>Struktura e Teknologjise e Informacionit (IT)</b></p> <p>Entiteti nuk ka në strukturë staf eficient për mbulimin e sistemit të IT.</p>	<p>Entiteti duhet të investojë për funksionimin e një strukturë të IT-e efektive për aktivitetin e tij në mënyrë eficiente.</p>	<p>Marrim në konsideratë rekomandimin e audituesve.</p>

## Aneks 1. Letra e menaxhimit

### Shirotë

#### Kërkesat e Ligjit nr. 43/2015, Nenin 11 pika 7

Audituesit kanë konstatuar se ERE ka përcaktuar paqën dhe strukturën në përputhje me kete kerkesa. Me anë të vendimit nr. 46, nr. 47 dhe nr. 61 të vitit 2016 janë miratuar Rregullorja për trajtimet financiare bazë të punonjësve të ERE, trajtimi financiar bazë me karakter të përkohshëm si edhe përcaktimi i nivelit të trajtimit financiar bazë për kushtet e tregut të punës.

#### Përgjegjësia e Drejtimit për Objektivat dhe Kufizimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Komentet e mëposhtme u referohen përgjegjësisë së Drejtimit për sistemin e brendshëm të kontroleve, ku objektivat dhe kufizimet e qenësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm janë marrë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Federates Ndërkombëtare të Kontablisteve.

#### Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontroleve të brendshme. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Drejtimi duhet të vlerësojë përfundimisht dhe kostat e pritura përkatëse të politikave dhe procedurave për kontrollin e brendshëm.

#### Objektivat

Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshëm janë që të japin siguri drejtimi, sa më shumë të jetë e mundur, që asetet të jenë të mbrojtura nga perdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi, dhe se transakcionet janë ekzekutuar në përputhje me politikat e drejtimit dhe të regjistruar saktë, në mënyrë që të mundësohet përgatitja në kohë e informacionit të besueshëm financiar në përputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

#### Kufizimet

Për shkak të kufizimeve të qenësishme në çdo sistem të kontrollit të brendshëm, gabimet apo parregullitë, mund të ndodhin dhe të mberen të pazbuluara. Gjithashtu, parashikimi i çdo vlerësimi të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme është subjekt i rrezikut që politikat dhe procedurat mund të bëhen të papërshtatshme për shkak të ndryshimeve të kushteve ose efektiviteti i hartimit dhe i zbatimit të politikave dhe procedurave mund të përkeqësohet.